



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI**

URDHËR

Nr. 1, datë 10.01.2017

**PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT 2017 - 2021
“MBËSHKETJE PËR ZHVILLIMIN E POLITIKAVE INOVATIVE BAZUAR
NË MODELIN “TRIPLE HELIX”**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 12, të Ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”

URDHËROJ:

1. Miratimin e Planit të Veprimit 2017 - 2021 “Mbështetje për zhvillimin e politikave inovative, bazuar në modelin “*Triple helix*”, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Krijimin e grupit ndërinstitucional të punës për zbatimin e Planit të Veprimit 2017 - 2021 “Mbështetje për zhvillimin e politikave inovative, bazuar në modelin “*Triple Helix*”.
3. Grupi ndërinstitucional i punës kryesohet nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe përbëhet nga:
 - Përfaqësues nga Ministria e Financave;
 - Përfaqësues nga Ministria e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike;
 - Përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;

- Përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit;
 - Drejtori i Departamentit të Zhvillimit, Financimit dhe Ndhmës së Huaj në Kryeministri;
 - Drejtori Ekzekutiv i AIDA-s;
 - Përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Informacionit.
4. Në mbledhjet e grupit ndërinstitucional, në varësi të çështjeve që do të diskutohen, ftohen të marrin pjesë përfaqësues të komunitetit të biznesit, ofruesit e mbështetjes për inovacionin, përfaqësues të shoqërisë civile, të universiteteve, të qendrës “PROTIK” dhe të komunitetit të donatorëve për mundësimin e kontributit të tyre për zbatimin e planit të veprimit.
 5. Objekti i veprimtarisë së grupit ndërinstitucional të punës është të sigurojë periodikisht zbatimin dhe monitorimin për çdo aktivitet të parashikuar në planin e veprimit për inovacionin, sipas fushës së veprimtarisë të çdo institucioni.
 6. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes të koordinojë procesin sipas pikës 5, të këtij urdhri.
 7. Ngarkohen të gjitha institucionet, sipas pikës 3, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA



Plani i Veprimit për 2017-2021 “Mbështetje për Zhvillimin e Politikave të Inovacionit Bazuar në modelin “Triple Helix”

Nr.	Aktivitetet	Masat	Afati kohor	Treguesit	Nevoja për financim (Burimi)	Institucionet përgjegjëse
Shtylla 1: Mjedisi Favorizues për Inovacionin						
1.1	Ngritja e Këshilli Kombëtar për Inovacionin, duke përfshirë një Sekretariat Teknik Këshilli kombëtar shërben për koordinimin e politikave/vendimmarrjen mbi bazën e strukturave ekzistuese dhe e një sekretariati në nivel operativ	Përgatitja e aktit ligjor për ngritjen e këshillit	Gjashtë mujori i parë i vitit 2017	<ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i Këshillit dhe sekretariatit • Nr. i takimeve dhe i pjesëmarrësve • Nr. i nismave të propozuara 	Nuk është parashikuar asnjë financim (nëse është e nevojshme, mund të përdoret financimi për <i>IPMG</i>)	MZHETTS, MAS, MIAP, KM, AIDA, AKKSHI, bizneset, akademia
		Ngritja e sekretariatit	Gjashtë mujori i parë i vitit 2017			
		Takimet e rregullta të Këshillit Kombëtar për Inovacionin	periodikisht			
1.2	Zhvillimi i kapaciteteve për agjencitë qendrore që ofrojnë shërbime mbështetëse për inovacionin Hartimi dhe zbatimi i një programi që specifikon llojin e kapaciteteve të nevojshme (duke u fokusuar tek AIDA, AKKSHI, etj.) dhe mënyrën sesi ato mund të zhvillohen për të zbatuar një qasje të integruar	Sigurimi i financimit dhe konsultimet me aktorët	Gjashtë mujori i dytë i vitit 2017 e në vazhdim	<ul style="list-style-type: none"> • Programi për zhvillimin e kapaciteteve e hartuar dhe e pranuar nga partnerët • Nr. i pozicioneve të reja të krijuara dhe të plotësuara në agjenci • Nr. i ndërmarrjeve që përdorin shërbimet informuese dhe lehtësuese dhe <i>feedback</i>-un • Nr. i projekteve të inovacionit të mbështetura 	20,000 - 30,000 € për strategjinë (partnerët ndërkombëtarë për bashkëpunim/donatorët) 100,000 € për vit për zbatimin, p.sh. pozicionet shtesë, trajnimi dhe instruktimi, kostot e jashtme (buxheti i shtetit & financimi nga BE)	MZHETTS, MAS, MIAP, AIDA, AKKSHI
		Përgatitja e termave të referencës dhe kontraktimi i konsulentëve	Gjashtë mujori i dytë i vitit 2017			
		Fillimi i punës për hartimin e programit për zhvillimin e kapaciteteve	Gjashtë mujori i dytë i vitit 2018			
		Konsultimi dhe diskutimi I programit	Gjashtë mujori i dytë i vitit 2018-2019			
		Zbatimi i rekomandimeve	periodikisht			
1.3	Krijimi i një rrjeti virtual për mbështetjen e inovacionit/identifikimin e mëshetjes së inovacionit Krijimi i një portali online - bazuar në një identifikim të plotë - i cili ndihmon sipërmarrësit, <i>SME</i> (NVM-të), institucionet kërkimore, OJQ-të, organet publike për të identifikuar dhe aksesuar mundësitë përkatëse për mbështetje	Sigurimi i financimit dhe konsultimi me aktorët	Gjashtë mujori i parë i vitit 2018	<ul style="list-style-type: none"> • Nr. i "anëtarëve" (ofruesve të shërbimit) të mbuluar • Nr. i vizitorëve të portalit dhe niveli i kënaqësisë së tyre • Nr. i përdoruesve të tregut dhe i transaksioneve të kryera • Nr. i bashkëpunimeve të mëtejshme të iniciuara brenda rrjetit 	50,000 - 100,000 € plus 3,000 € për vit për mirëmbajtje/përditësim (buxheti i shtetit/ AIDA, partnerët ndërkombëtarë për bashkëpunim/donatorët, sponsorët)	AIDA, MZHETTS, MAS, MIAP, ofruesit e mbështetjes për inovacionin
		Përgatitja e termave të referencës dhe kontraktimi i ofruesit të shërbimeve	Gjashtë mujori i dytë i vitit 2018			
		Informacioni kërkimor, identifikimi i nevojave	Gjashtë mujori i dytë i vitit 2018			
		Ndërtimi i portalit	Gjashtë mujori i parë i vitit 2019			
		Lançimi i portalit	Gjashtë mujori i dytë i vitit 2019			
		Përditësimi i portalit, vendosja e lidhjeve	periodikisht			

Plani i Veprimit për 2017-2021 “Mbështetje për Zhvillimin e Politikave të Inovacionit Bazuar në modelin “Triple Helix”

Nr.	Aktivitetet Prioritare	Masat Kyçe	Kuadri Kohor	Treguesit	Nevoja për financim (Burimi)	Përgjegjësia
1.4	Zhvillimi i Konkursit “Triple Helix” Vazhdimi i konkursit të organizuar në vitin 2015 nga OECD, së bashku me MZHETTS dhe AIDA.	Sigurimi i financimit dhe konsultimi me aktorët	Gjashtë mujori i parë i vitit 2018	<ul style="list-style-type: none"> Nr. i aplikimeve Nr. i aplikimeve të prezantuara përpara jurisë Nr. i projekteve të zbatuara, impakti ekonomik (p.sh. vendet e punës, investimet) 	25,000 - 35,000 € për vit (buxheti i shtetit / AIDA-s, partnerët ndërkombëtarë për bashkëpunim/donatorët, sponsorët, kontributet në natyrë)	AIDA, AKKSHI, MZHETTS, MAS, MIAP, ofruesit e mbështetjes për inovacionin, shoqatat e biznesit
		Përditësimi/ përmirësimi i udhëzimeve të konkursit	Gjashtë mujori i parë i vitit 2018			
		Lançimi i konkursit dhe i thirrjes për propozime	Gjashtë mujori i dytë i vitit 2018			
		Ceremonia e çmimeve	Gjashtë mujori i dytë i vitit 2018			
		Vazhdimi i konkursit çdo vit	periodikisht			
Shtylla 2: Kapitali Njerëzor për Inovacionin						
2.1	Futja në përdorim e një skeme të mbështetjes financiare për PhD-të industriale dhe të diplomuarit e talentuar në projektet e inovacionit Ofrimi i mbështetjes financiare për punësimin e talenteve të kualifikuar në projektet për kërkim dhe zhvillim (K&ZH) dhe në projektet e inovacionit duke mbuluar (1) asistencën për PhD Industriale dhe (2) asistencën për NVM-të që punësojnë të diplomuarit e talentuar për projektet e inovacionit	Konsultimet me aktorët, specifikimi i kushteve dhe kriterëve për programin mbështetës	Gjashtë mujori i parë i vitit 2018	<ul style="list-style-type: none"> Nr. i kompanive pjesëmarrëse dhe i kandidatëve të PHD dhe i të diplomuarve të punësuar Nr. i kompanive që punësojnë talentet përtej kohëzgjatjes së mbështetjes Nr. i kompanive të cilat kanë përfunduar K&ZH dhe projektet e inovacionit me sukses 	200,000 - 250,000 € për vit (buxheti i shtetit, financim i BE)	MZHETTS, MAS, AIDA, AKKSHI
		Sigurimi i financimit për programin mbështetës	Gjashtë mujori i parë i vitit 2018			
		Ngritja e kuadrit ligjor/rregullator dhe institucional për programin mbështetës	Gjashtë mujori i dytë i vitit 2018			
		Shpallja e programit dhe promovimi	Gjashtë mujori i parë i vitit 2019			
		Thirrja për propozime	Gjashtë mujori i parë i vitit 2020			
		Zbatimi i programit	periodikisht			
2.2	Nxitja e bashkëpunimit Biznes-Akademi-Qeveri Përpjekjet të përbashkëta në lidhje me mundësitë e bashkëpunimeve përsa i përket zhvillimit të kapitalit njerëzor dhe për të identifikuar idetë për përafrimin e kurrikulave me nevojat e kompanive dhe përmirësimin e kuadrit përkatës ligjor	Përgatitja e një plani masash për komunikimin, konsultimet me aktorët e interesit	Gjashtë mujori i dytë i vitit 2017	<ul style="list-style-type: none"> Nr. i eventeve dhe i pjesëmarrësve Nr. i artikujve të publikuar Nr. i ideve për përmirësimet të identifikuara dhe të pranuar 	Nuk ekziston asnjë nevojë e ngutshme për financim (nëse është e nevojshme, buxhetet për komunikimin të ministrive/agjencive, sponsorizimet)	MAS, MZHETTS, MIAP, AIDA, AKKSHI, shoqatat e bizneseve, universitetet
		Zbatimi i masave, organizimi i eventeve, tryezave të rrumbullakta, artikuj....etj.	2018-2021			
		Vlerësimi i masave konkrete për përmirësimin e kuadrit ligjor	periodikisht			

Plani i Veprimit për 2017-2021 “Mbështetje për Zhvillimin e Politikave të Inovacionit Bazuar në modelin “*Triple Helix*”

Nr.	Aktivitetet Prioritare	Masat Kyçe	Kuatri Kohor	Treguesit	Nevoja për financim (Burimi)	Përgjegjësia
Shtylla 3: Infrastruktura për Mbështetjen e Inovacionit						
3.1	Ofrimi i mbështetjes për programet e inkubatorëve dhe të akseleratorëve Sigurimi i financimit për programet për inkubatorët dhe akseleratorët mbi bazën e konkurrencës për të zgjeruar burimet dhe shërbimet për mbështetjen e biznesit, duke u fokusuar në modele të thjeshta organizative bazuar në partneritete me partnerët e jashtëm dhe me trajnerët (<i>coaches</i>)	Konsultimet me aktorët, specifikimi i kushteve dhe kriterëve për programin mbështetës	Gjashtë mujori i parë i vitit 2018	<ul style="list-style-type: none"> • Nr. i programeve të përzgjedhura për inkubatorët dhe akseleratorët • Nr. i start-up-eve të asistuara dhe i vendeve të punës të hapura • Shkalla e mbijetesës së ndërmarrjeve p.sh. pas tre vitesh 	200,000 – 250,000 € për vit (buxheti i shtetit, financimi i BE)	MZHETTS, MIAP, MAS, AIDA, AKKSHI, universitetet, komuniteti i start-up-eve
		Sigurimi i financimit për programin mbështetës, ngritja e kuadrit ligjor/rregullator	Gjashtë mujori i parë i vitit 2018			
		Shpallja e skemës, dhe thirrja për aplikime dhe përzgjedhja	Gjashtë mujori i dytë i vitit 2018			
		Mbështetja e programeve të përzgjedhura për inkubatorët/akseleratorët	2018 - 2021			
		Vlerësimi i masave konkrete për përmirësimin e kuadrit ligjor	2021			
3.2	Vlerësimi i potencialit të cluster-ave dhe i konceptit për futjen në përdorim të qasjes së orientuar nga cluster-at në Shqipëri Vlerësimi i parakushteve dhe zhvillimi i një koncepti zbatimi që përshkruan fazat kryesore dhe fushat kryesore të politikës dhe instrumentet për mbështetjen e procesit	Sigurimi i financimit, përgatitja e Termave të Referencës dhe përzgjedhja e konsulentit	Gjashtë mujori i parë i vitit 2019	<ul style="list-style-type: none"> • Koncepti i finalizuar dhe i pranuar nga aktorët • Nr. dhe struktura e anëtarëve të cluster-it • Nr. i instrumenteve të orientuara nga cluster-at të zbatuara • Zhvillimi i veprimtarisë së inovacionit, qarkullimit/xhiros, eksporteve, punësimit në cluster-a 	20,000 – 30,000 € duke përjashtuar kostot e zbatimit (partnerët ndërkombëtarë për bashkëpunim/donatorët)	MZHETTS, MIAP, MAS, AIDA, AKKSHI
		Nisja e punës (<i>Kick-off</i>)	Gjashtë mujori i dytë i vitit 2019			
		Finalizimi dhe prezantimi	Gjashtë mujori i dytë i vitit 2019			
		Konsultimi dhe diskutimi	Gjashtë mujori i dytë i vitit 2019			
		Zbatimi i qasjes së orientuar nga cluster-at	periodikisht			

Plani i Veprimit për 2017-2021 “Mbështetje për Zhvillimin e Politikave të Inovacionit Bazuar në modelin “*Triple Helix*”

Nr.	Aktivitetet Prioritare	Masat Kyçe	Kuadri Kohor	Treguesit	Nevoja për financim (Burimi)	Përgjegjësia
Shtylla 4: Instrumentet Financiare për Kërkimin, Zhvillimin dhe Inovacionin						
4.1	Krijimi i një rrjeti të engjëjve të biznesit (<i>business angels</i>) Krijimi i një Rrjeti të Engjëjve të Biznesit (<i>business angels</i>) i cili lehtëson përputhshmërinë e sipërmarrësve me engjëjt e biznesit paralelisht me zhvillimin e kuadrit ligjor të nevojshëm mbështetës	Rritja e ndërgjegjësimit dhe konsultimi me aktorët	Gjashtë mujori i parë i vitit 2019	<ul style="list-style-type: none"> Nr. i akteve ligjore dhe nënligjore të formuluar, konsultuara dhe të nxjerra zyrtarisht Nr. i engjëjve të biznesit në rrjet Nr. i start-up-ve që aplikojnë për sesionet e lançimit të ideve të reja Nr. i <i>start-up-ve</i> që marrin pjesë në sesionet e lançimit të ideve të reja Nr. i investimeve të mundësuar nga rrjeti 	(Nuk është parashikuar asnjë nevojë e ngutshme për financim për fazën pilot të iniciuar nga PROTIK (aktivitetet kryesore do të financohen nga kuotat e anëtarësisë) Shtirirja (<i>roll-out</i>) përtej TIK-ut mund të mbështetet nga partnerët ndërkombëtarë për bashkëpunim/donatorët, financim i BE-së, sipas nevojës)	<u>PROTIK</u> , MZHETTS, MIAP, ofruesit e mbështetjes për inovacionin (p.sh. Qendra e Inovacionit), investitorët privatë (engjëjt e biznesit)
		Hartimi i kuadrit mbështetës ligjor	Gjashtë mujori i parë i vitit 2019			
		Identifikimi i engjëjve potencialë të biznesit	Gjashtë mujori i parë i vitit 2019, në vazhdim			
		Përcaktimi i strukturës, veprimtarive, metodologjisë së kombinimit dhe kodit të sjelljes	Gjashtë mujori i parë i vitit 2019			
		Identifikimi dhe përzgjedhja e projekteve dhe e sipërmarrësve potencialë	Gjashtë mujori i dytë i vitit 2019, në vazhdim			
		Trajnimi/përgatitja e <i>start-up-ve</i> dhe e anëtarëve	Gjashtë mujori i dytë i vitit 2019, në vazhdim			
		Krijimi i rrjetit dhe organizimi i forumeve për investimet	periodikisht			
4.2	Zbatimi i një skeme efektive me Voucher-a për Inovacionin Zbatimi i skemës voucher e cila stimulon NVM-të për të siguruar mbështetje nga ekspertët për të futur në përdorim inovacione në biznese.	Sigurimi i financimit, organizimi i proceseve të menaxhimit dhe monitorimit	Gjashtë mujori i dytë 2018 e në vazhdim	<ul style="list-style-type: none"> Nr. i aplikimeve Nr. dhe volumi i voucher-ave të paguar tërësisht Investimet totale në projektet e inovacionit Nr. i projekteve të përfunduara me sukses Nr. i partneriteteve afatgjata të nxitura 	250,000 - 300,000 € në vit (buxheti i shtetit)	<u>AIDA</u> , MZHETTS, AKKSHI
		Thirrja e parë për propozime, aktivitetet promicionale	Gjashtë mujori i dytë 2018 e në vazhdim			
		Zbatimi i skemës, thirrja e rregullt për propozime	Gjashtë mujori i dytë 2018 e në vazhdim			
		Vlerësimi i fazës së parë, përmirësimi i skemës	periodikisht			

Plani i Veprimit për 2017-2021 “Mbështetje për Zhvillimin e Politikave të Inovacionit Bazuar në modelin “Triple Helix”

Nr.	Aktivitetet Prioritare	Masat Kyçe	Kuatrit Kohor	Treguesit	Nevoja për financim (Burimi)	Përgjegjësia
4.3	Kryerja e një studimi fizibiliteti për zgjerimin e skemave të financimit për të nxitur inovacionin dhe rishikimi i kuadrit përkatës ligjor Kryerja e vlerësimit të potencialit për skemat e reja të financimit të orientuara nga nevojat (si instrumentet për financimin e kapitalit që mbulojnë faza të ndryshme, grantet për më shumë kërkime komplekse bashkëpunuese dhe projekte të inovacionit ose mbështetja për projektet e bashkëpunimit me diasporën) dhe rishikimi i kuadrit përkatës ligjor për skemat e reja të financimit të propozuara.	Përgatitja e Termave të Referencës, sigurimi i financimit	Gjashtë mujori i dytë 2017	<ul style="list-style-type: none"> • Nr. i skemave të riprojektuara/porsa projektuara • Nr. i akteve ligjore dhe nën-ligjore të formuluar, konsultuara dhe të nxjerra • Nr. i projekteve/ndërmarrjeve të financuara • Nr. i projekteve të përfunduara me sukses, impakti, p.sh. përsa i përket vendeve të punës të hapura 	25,000 - 35,000 € (partnerët ndërkombëtarë për bashkëpunim/donatorët)	MZHETTS, MF, MIAP, MAS
		Përzgjedhja e konsulentëve	Gjashtë mujori i dytë 2017 e në vazhdim			
		Nisja e punës (<i>Kick-off</i>) dhe konsultimet me aktorët	Gjashtë mujori i parë 2018 e në vazhdim			
		Raporti përfundimtar dhe prezantimi i rekomandimeve	Gjashtë mujori i dytë 2018 e në vazhdim			
		Përgatitja e kuadrit ligjor për skemat e reja të financimit (financimi i kapitalit, kërkimet komplekse bashkëpunuese dhe projektet e inovacionit)	2018-2021 e në vazhdim			
Zbatimi i skemave të reja të financimit	2018-2021 e në vazhdim					
4.4	Vlerësimi i potencialit të stimujve fiskalë për të nxitur inovacionin Përgatitja e rekomandimeve për stimujt e përshtatshëm fiskalë dhe për karakteristikat kyçe të projektimit (Iloji, baza e përllogaritjes, shpenzimet e lejuara, shënjestrimi, proceset, monitorim & vlerësim - M&V) për të rritur shpenzimet për inovacionin dhe përmirësuar performancën e inovacionit	Sigurimi i financimit, përgatitja e Termave të Referencës, përzgjedhja e konsulentëve	Gjashtë mujori i dytë 2017 e në vazhdim	<ul style="list-style-type: none"> • Nr. dhe karakteristikat strukturore të përfituesve • Rritja e shpenzimeve për veprimtaritë e inovacionit • Produkti i inovacionit (numri i përfituesve që fusin në përdorim produkte, shërbime, procese, etj. inovatore) 	20,000 – 30,000 € duke përfshirë kostot e zbatimit (partnerët ndërkombëtarë për bashkëpunim/donatorët)	MZHETTS, MF, MIAP, MAS
		Nisja e punës (<i>Kick-off</i>) dhe konsultimet me aktorët	Gjashtë mujori i dytë 2018 e në vazhdim			
		Raporti përfundimtar dhe prezantimi i rekomandimeve	Gjashtë mujori i dytë 2018 e në vazhdim			
		Konsultimi dhe diskutimi	Gjashtë mujori i dytë 2018 e në vazhdim			
		Zbatimi i stimujve financiarë	Gjashtë mujori i dytë 2018-2021 e në vazhdim			

Lista e shkurtimeve

AADF	Albanian-American Development Foundation Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim
AIDA	Albanian Investment Development Agency Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve
BMZ	(German) Federal Ministry for Economic Cooperation and Development Ministria Federale (Gjermane) për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
EBRD	European Bank for Reconstruction and Development Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
GIZ	Deutsche Gesellschaft fuer Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH Shoqëria Gjermane për Bashkëpunimin Ndërkombëtar
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
M&V	Monitorimi dhe Vlerësimi
MZHETTS	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sporteve
MF	Ministria e Financës
MIAP	Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike
AKKSHI	Agjencia Kombëtare për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin
KM	Kryeministria
PPP	Partneriteti Publik Privat
NVM	Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme
USAID	United States Agency for International Development Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar